



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 69/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muahmet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 28.04.2012, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.04.2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se subjekti politik PDK, dega në Ferizaj ka vendosur një shator, për qëllime propagandistike, sipas parashtresës së ankesës është zënë hapësira publike dhe është shkelur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Parashtresesi i ankesës kërkon nga PZAP-i, që të ndërmerren masat e parapara ligjore ndaj subjektit politik PDK.

**Neni 118 paragrafi 1 i LZP, përcakton se:**

*PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

**Neni 3 paragrafi 6 pika c, e Rregullave dhe Proceduarve të PZAP-it përcakton:**

*(c) hollësi rreth çfarë do dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rast kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pabazuar, për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 3 paragrafi 6 pika c të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, sepse në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë që PZAP-i ti vlerëson pretendimet ankimore, andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 69/2012 më datën 28.04.2012.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



Prishtinë / Priština